

**BASHKIA KORÇË**

**PROJEKT DOKUMENTI  
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM  
2023 – 2025 FAZA E DYTË**

**GUSHT 2022**

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË KORÇË	8
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	9
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË KORÇË	9
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË KORÇË	10
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	10
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	10
4. BUXHETI AFATMESEM I BASHKISË KORÇË 2023-2025	17
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË KORÇË NË VITET 2023-2025	17
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Korçë për vitet 2023-2025	17
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	22
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	22
TRANSFERTA E KUSHTËZUAR	23
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Korçë për periudhën 2023-2025	23
5. BUXHETI AFATMESEM PËR PROGRAMET BUXHETORE	27
5.1 PROGRAMI 01110 - PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM	27
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	28
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	29
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	32
5.2 PROGRAMI 03140 – SIGURIA PUBLIKE	33
5.2.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	34
5.2.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	36
5.2.3 Projektet e Investimeve të Programit	37
5.3 PROGRAMI 04130 – MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK VENDOR	37
5.3.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	38
5.3.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	41
5.3.3 Projektet e Investimeve të Programit	45
5.4 PROGRAMI 05100 – MENAXHIMI I MBETJEVE, REDUKTIMI I NDOTJES, MBROJTJA E MJEDISIT	45
5.4.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	47
5.4.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	47
5.4.3 Projektet e Investimeve të Programit	50
5.5 PROGRAMI 06260 – SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE	50
5.5.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	52
5.5.2 Plani i shpenzimeve të produkteve të Programit	56
5.4.3 Projektet e Investimeve të Programit	70
5.6 PROGRAMI 08130 – KULTURA, SPORT DHE ARGËTIM	71
5.6.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	72
5.6.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	75
5.6.3 Projektet e Investimeve të Programit	83
5.7 PROGRAMI 09120 – ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR	83
5.7.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	85
5.7.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	87

5.7.3 Projektet e Investimeve të Programit	92
5.8 PROGRAMI 09230 – ARSIM I MESËM I PËRGJITHSHËM	92
5.8.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	93
5.8.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	94
5.8.3 Projektet e Investimeve të Programit	98
5.9 PROGRAMI 10430 – PËRKUJDESI SOCIAL	98
5.9.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	99
5.9.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	101
5.9.3 Projektet e Investimeve të Programit	107
6. INFORMACION FINANCIAR SUPLEMENTAR	107
7. DETYRIMET E PRAPAMBETURA	109
8. TREGUESIT FINANCIARË	109
8.1. RREZIQET FINANCIARE DHE FISKALE	110

### Lista e Tabelave

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Korçë	18
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	19
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.	24
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas Funksioneve	25
Tabela 01110-1. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	29
Tabela 01110-2. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	29
Tabela 01110-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	31
Tabela 01110-4. Projektet e Investimeve të Programit	34
Tabela 03140-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	36
Tabela 03140-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	36
Tabela 03140-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	38
Tabela 04130-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	40
Tabela 04130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	41
Tabela 04130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	46
Tabela 04130-4. Projektet e Investimeve të Programit	52
Tabela 05100-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	53
Tabela 06260-2. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	59
Tabela 06260-3. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	60
Tabela 06260-4. Projektet e Investimeve të Programit	81
Tabela 08130-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	82
Tabela 08130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	83
Tabela 08130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	88
Tabela 08130-4. Projektet e Investimeve të Programit	97
Tabela 09120-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	98
Tabela 09120-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	99
Tabela 09120-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	104
Tabela 09120-4. Projektet e Investimeve të Programit	117
Tabela 09230-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	117
Tabela 09230-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	118
Tabela 09230-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	124
Tabela 09230-4. Projektet e Investimeve të Programit	124
Tabela 10430-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	124
Tabela 10430-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	125
Tabela 10430-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	129
Tabela 10430-4. Projektet e Investimeve të Programit	136

### Lista e Figurave

Figura 1. Të Ardhurat e Bashkisë Korçë sipas Burimit (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit)

21

### Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

## 1. HYRJE

### 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksat e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në

dispozicion në të ardhmen, u mundëson njërive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART<sup>1</sup>. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë<sup>2</sup> (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare<sup>3</sup>, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zëmrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV. Një element i

<sup>1</sup> Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

<sup>2</sup> 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

<sup>3</sup> Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart<sup>4</sup> i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
  - Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
  - Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)
- Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2023-2025 përfshijnë:
- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
  - Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
  - Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për

<sup>4</sup> Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore"

ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

## 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Korçë

Rrethi i Korçës shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë, në Krahinën Malore Qëndrore. Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Shtrihet në pjesën Juglindore të vendit, në rrëzë të malit të Moravës, në lartësinë 869 metra mbi nivelin e detit. Relievi është kryesisht malor e kodrinor. Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishmi është lumi i Devollit me degën Dunavec dhe Osumi i sipërm. Korça kufizohet në veri me qytetin e Pogradecit i cili ndodhet 41 kilometra, në jug me qytetin e Ersekës 45 kilometra, në lindje me Bilishtin 27 kilometra dhe në perëndim me Skraparin. Qyteti i Korçës ndodhet 181 kilometra larg kryeqytetit të vendit, Tiranës. Popullsia e Bashkisë Korçë numëron 129 654 banorë.

Korça karakterizohet nga një klimë pjesërisht mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Për të gjithë ata që preferojnë klimën malore, në verën e nxehtë, Korça dhe rrethinat e saj do t'ju ofrojnë freskinë, ajrin e pastër dhe një natyrë të mrekullueshme. Për më tepër Korça gjatë gjithë vitit ofron aktivitete të shumta kulturore, festa e panaire që do ta bënin akoma më të këndshëm qëndrimin tuaj në këtë qytet. Shumë interesante janë edhe festat e kthyer tashmë në një traditë për qytetin si, Karnavalet e Korçës, Festa e Birrës, Pashkët, Krishtlindjet, etj.

Korça është qendra më e madhe administrative e Shqipërisë juglindore, qyteti më i madh i rajonit i themeluar në shekullin e 15-të. Megjithëse jeta qytetare lindi në mesjetën e vonë, terreni ka qenë i banuar shumë shekuj më parë. Studiuesit kanë vërtetuar se zona ku ndodhet sot qyteti ka qenë e banuar që në kohët e lashta. Gjatë epokave të antikitetit ka pasur një lulëzim jete, ky i përqëndruar më tepër në rrëzë së kodrave të Korçës. Pas ardhjes së Iliaz Bej Panaritit në fshatin e Peshkëpisë që ndodhet afër qytetit, Korça pësoi shumë ndryshime. Ai ndërtoi një xhami të madhe në vitin 1496 si dhe Pazarin e Korçës. Në shekullin XVII- XVIII qyteti u zgjerua. Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, Korça u bë një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike, tregëtare dhe kulturore të vendit, me një pazar të madh dhe karakteristik, i cili zë një vend të veçantë midis monumenteve të kulturës të qyteteve të tjera të Shqipërisë. Gjatë viteve të Rilindjes Kombëtare, në Korçë u zhvillua një veprimtari e gjerë patriotike e mbështetur nga shumë atdhetarë, ku fryt i punës së tyre ishte dhe hapja e Shkollës të parë Shqipe. Më 10 dhjetor 1916, si rezultat i përpjekjeve të patriotëve korçarë me në krye Themistokli Gërmenjin, u shpall Krahina Autonome e Korçës.

Në vitet e formimit të shtetit Shqiptar, Korça dallohej nga qytetet e tjera për nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe urban. Në dekadat e para të shekullit të XX, Korça u bë një nga qytetet me



aktivitet më të dendur kulturor, arsimor dhe publicistik dhe në tetor të vitit 1917 u çel Liceu i Korçës i cili përgatiti breza intelektualësh që lanë gjurmë në historinë dhe kulturën kombëtare. Sot Korça, në aspektin kulturor dhe arsimor vazhdon t'i ruajë dukshëm traditat e saj duke u renditur ndër qytetet e para në Shqipëri. Korça, qyteti më i vizituar në Shqipëri, është i pasur me muzeume nga më të veçantët, si Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Muzeu Kombëtar i Arsimit, Muzeu "Gjon Mili", Muzeu Oriental "Bratko", si edhe Shtëpia Muze e piktorit "Vangjush Mio", të cilët presin vizitorë gjatë gjithë vitit. Askush nuk mund të largohesh nga Korça pa provuar gatimet tradicionale, pa vizituar parqet, pa udhëtuar në pikat më të bukura turistike si Dradha, Voskopoja, Vithkuqi, Boboshtica, të preferuara nga turistët në çdo stinë. Korça është qyteti model, qyteti i kulturës, i arsimit, i festave më të bukura në Shqipëri, qyteti që ofron çdo gjë për këdo që e viziton.

## 2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

(Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik PPV/PZHS)

Korça e kulturës, historisë, dizajnit urban dhe natyrës, një Bashki që ngjall krenarinë, zgjon pasionin dhe ndjenjën e përkatësisë për të gjithë banorët e saj.

Qendër rajonale me rëndësi kombëtare, me një ekonomi konkurruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi e turizëm të zhvilluar, e fokusuar tek inovacioni duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin.

Gjatë këtyre 15 viteve, përmes instrumenteve të planifikimit në përputhje me këtë dokument të strategjisë, Bashkia Korçë synon ta ndërtojë të ardhmen e saj mbi trashëgiminë e saj të pasur historike, kulturore dhe shoqërore. Këto trashëgimi, i kanë shërbyer dhe do vazhdojnë t'i shërbejnë Korçës si gurë themeli për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të hapësirave urbane dhe rurale gjithëpërfshirëse, të cilat zgjojnë ndjenjën e përkatësisë të hapësirave urbane, të të gjithë banorët e bashkisë. Prioriteti kryesor i Bashkisë Korçë është mirëqenia e qytetarëve të saj, të cilën synon që ta mbështesë përmes zhvillimit ekonomik, promovimit e mbështetjes së marrëdhënieve ndërkufitare, mbrojtjes së mjedisit, përmirësimit të infrastrukturës dhe gjithë përfshirjes sociale. Ky plan i reflekton më së miri këto dimensione duke i detajuar ato në një plan territorial të zbatueshëm.

Plani vjen njëkohësisht pas një reforme të rëndësishme territoriale duke krijuar për Bashkinë tonë tashmë një realitet kompleks mjedisesh urbane, me qytetin e Korçës dhe 7 njësi administrative me profil rural. Plani fokusohet tek ky realitet dhe jep zgjidhje të qëndrueshme zhvillimore për përmirësimin e situatës.

Korça po forcohet ndjeshëm e do të vazhdojë të jetë një qendër e një poli rajonal me rëndësi kombëtare, e cila në mënyrë të qëndrueshme do të fuqizojë asetet turistike, bujqësore dhe natyrore që disponon. Korça dhe korçarët kanë rigjetur krenarinë e tyre dhe ka një besim të madh ndër qytetarët tanë se ne jemi një Bashki që punojmë për të ardhmen, një Bashki inovative, e gatshme për të ndërmarrë projekte strategjike në funksion të përmirësimit të jetesës së tyre. Duke qenë të ndërgjegjshëm për potencialin e këtij territori dhe banorëve të saj, si dhe të përkushtimit dhe punës prej brezash për ta pasuruar atë, synimi kryesor i joni është që me fuqitë tona aktuale të ndërtojmë një territor akoma më të frytshëm, akoma më të shëndetshëm, akoma më ftues dhe mbështetës për t'u trashëguar përmes brezave që do të vijnë.

## 2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Korçë

(Burimi i Informationit: PPV / PZHS)

Politikat e energjisë të një vendi shërbejnë për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjitike dhe optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Hartimi dhe zbatimi i politikave të cilat sigurojnë furnizimin me energji elektrike bëhet në nivel qendror dhe përgjegjëse për këtë është Ministria e Energjisë dhe Industrisë prandaj edhe çështjet lidhur me këtë sektor duhet të zgjidhen në nivel kombëtar dhe të jenë subjekt i një plani sektorial mbi energjinë.

### 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Korçë

#### 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)

#### 3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS; Fishat e Projekteve, të tjera)

Kompletimi i adoptimit dhe zbatimit të standarteve Europiane mbi cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër;

Konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standarteve Europiane;

Adoptimi e zbatimi i planeve të veprimit mbi cilësinë e ajrit si në nivel qendror dhe atë lokal.

#### Fishat e Projekteve Prioritare në Infrastrukturën Rrugore

##### Fisha e projektit -Transporti

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret</b> <i>Projekti 1.1.1.1</i> By-Pass-i Jashtë qytetas (KartëProjekti)
Objektivi Strategjik/ Programi (SWOT)	Sipas Analizes SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik, Programin etj. <b>Synimi 1</b> Bashki me infrastrukturë e Logjistike bashkëkohore transporti si “Porta” Juglindore e vëndit në Korridorin VIII
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë <i>Objektivi 1.1</i> Eliminimi i trafikut që kryqezohet me mjedisin urban, i lidhur me praninë e trafikut te korridorit VIII
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	- Planifikimi i Projektit, fazave të tij /planifikimi financiar Pjesë e Planit Kombëtar të Transportit - Sensibilizimi i komunitetit si dhe vlerësimi i Impaktit Mjedisor - Të promovohet për tu përfshirë në “Planin Kombëtar të Transportit Shqipëtar (ANTP) bypass-e, në kategorinë e Autostradës në Veri të Qytetit të Korçës në aksin SH3, në drejtim të Kakavisë (Kategoria A ), Studim fisibiliteti - Miratimi i Projektit sipas bazës ligjore në fuqi Plani Kombëtar i Transportit - Miratimi i Buxhetit Qeveria - Proçesi i Tenderimit Autoriteti Rrugor Shqiptar - Proçesi i Zbatimit MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Proçesi i Monitorimit e Kolaudimit te Projektit Auditim i Sigurisë Rrugore MIT- ARSH</li> <li>- Shënim: Veprimet Bazë Strategjike</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore</li> </ul>
Partnerët Burimet e nevojshme për realizimin e projektit	<p>Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit Buxheti i shtetit</li> </ul>
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	Indikatorët që masin Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrim i Impaktit që do të ketë Projekti i Realizuar

### Fisha e projektit - Transporti

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret</b> <i>Projekti By-Pass-Verior qytetas (Kartë Projekti)</i>
Objektivi Strategjik/ Programi (SWOT)	<p><b>Sipas Analizës SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik, Programin etj.</b></p> <p>Qytet i pastër, pa ndotje;</p> <p>-Rritja e sigurisë për banorët. Korça Bashki me infrastrukturë e Logjistikë bashkëkohore transporti si “Porta Kryesore” Juglindore e vëndit në Korridorin VIII</p>
Përshkrimi i Projektit	<p><b>Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë:</b> Eliminimi i trafikut në mjedisin e brendshëm urban, i lidhur me praninë e trafikut të Korridorit VIII , që mund të mos anashkalohet nga By-Pass-Verior qytetas dhe që duhet të shmanget nga mjedisi i brendshëm i qytetit flukset e trafikut që vijnë nga juglindja dhe nga Njësitë e reja administrative dhe kanë destinacion jashtë qytetit të Korçës</p>
	<p><b>-Planifikimi i Projektit, fazave të tij /planifikimi financiar</b> Pjesë e Planit të Transportit të Bashkisë. By-Passi do të projektohet për tu realizuar në tre Faza. Faza e parë: 1,1957km, Faza e dytë: 2,0068km , Faza e tretë: 0.9533km në total me një gjatësi 4.1558 km.</p> <p><b>-Sensibilizimi i komunitetit si dhe vlerësimi i Impaktit Mjedisor</b> Të promovohet për tu përfshirë në “Planin e Transportit të Bashkisë Korçë bypass-e, në kategorinë e Autostradës Urbane që përshkon pjesën veriore dhe perëndimore të</p>

Fazat e Projektit	qytetit në aksin SH75 (në Kategorin A1 për tu bashkuar në pjesën Veriore të Qytetit të Korçës në aksin SH3, në drejtim të Kakavijës (Kategoria A), Studim fisibiliteti
Dhe Termat Kohor	-Miratimi i Projektit sipas bazës ligjore në fuqi Plani Kombëtar i Transportit -Miratimi i Buxhetit Qeveria -Proçesi i Tenderimit Autoriteti Rrugor Shqiptar -Proçesi i Zbatimit MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar -Proçesi i Monitorimit e Kolauditimit të Projektit Auditim i Sigurisë Rrugore MIT- ARRSH
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore</li> </ul>
Partnerët Burimet e nevojshme për realizimin e projektit Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit,  -Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit Qeveria Shqiptare  Indikatorët që masin Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrim i Impaktit që do të ketë Projekti i Realizuar Qytet i pastër, pa ndotje; -Rritja e sigurisë të trafikut për banorët

### Fisha e projektit - Transporti

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret : KRyQËZIMET ME RRJETIN RRUGOR KRyESOR SHQIPTAR</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SWOT)	Sipas Analizes SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik, Programin etj. : Projekti është hartuar për të ulur vonesat dhe radhët e makinave në disa nga kryqëzimet më të ngarkuara në rrjetin  e rrugëve primare që hyjnë dhe dalin në qytetin e Korçës nëpërmjet rrjetit rrugor qendror me drejtim nga Tirana , Pika kufitare e Kapshticës dhe rruga që lidhet me Ersekën dhe të aksit juglindor (shif pikat me rreth të kuq në hartën më poshtë)

Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë : Në përputhje me rezultatet e modelimit dhe simulimeve të trafikut në flukset e pritshme të trafikut në korridorin VIII sipas studimit të ANTP janë përcaktuar nyjet e kryqëzimeve më të rëndësishme të rënditura më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Nyje kryqëzimi Nr. 1 në bypass-in verior-hyrja dalje për në Tiranë i pozicionuar në by-pasin e qytetit me kategori A1</li> <li>Nyje kryqëzimi Nr. 2 në bypass-in verior-hyrja dalje për Kapshticë i pozicionuar në by-pasin e qytetit me kategori A1</li> </ul>
------------------------	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nyje kryqëzimi Nr. 3 në bypass-in në pjesën juglindore të qytetit në drejtim të Ersekës</li> </ul> <p>Fazat e zbatimit të këtij projekti lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me zbatimin e projekteve të By-pasit ku janë pozicionuar këto kryqëzime</p>
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<p>Për çdo nyje kryqëzimi në disnivel parashikohen fazat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projektimi sipas funksioneve të rrugëve që lidh kryqëzimi;</li> <li>- Çpronësi tokës për zgjerim të karrexhatave;</li> <li>- Ndërtimi i mbikalimit ose nënkalimit;</li> <li>- Asfaltim;</li> </ul> <p><i>Veprimet Strategjike Faza A</i></p> <p>Ndërtimi i dy kryqëzimeve në disnivel si më poshtë: (Kjo fazë varet nga zbatimi i projektit 1.1.1.2:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nyje kryqëzimi Nr. 1 në bypass-in verior në drejtim të Tiranës</li> <li>- Nyje kryqëzimi Nr. 2 në bypass-in në drejtim të Kapshticës</li> </ul> <p>Faza B</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i kryqëzimeve në disnivel ose rrethrotullim të madh në varësi të flukseve të trafikut të llogaritura si më poshtë:</li> </ul> <p>Nyje kryqëzimi Nr. 3 në bypass-in për në</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ersekë</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore :</li> <li>- Krijimi i departamentit të transportit në Bashki</li> <li>- Matjet e trafikut</li> </ul>
Partnerët	Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit: Bashkia Korçë & ARRSH
Burimet e nevojshme për realizimin e projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit</li> </ul> <p><i>Kostoja e vlerësuar e ndërtimit 6 000 000 Euro Qeveria dhe Bashkia</i></p> <p><i>Rrisqet Bashkia nuk është në gjendje të përballojë koston e këtyre investimeve.</i></p>
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	<p>Indikatorët që masin Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrim i Impaktit që do të ketë Projekti i Realizuar :</p> <p><i>Justifikimi i Projektit - Rritje e sigurisë në rrugë; Trafik i lehtësuar;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ulje e bllokimit të trafikut.</li> </ul> <p><i>Objektivi i gjerë</i> Eliminimi i trafikut që kryqëzohet me mjedis urban ndërmjet automjeteve të lehta dhe të rënda , i lidhur me praninë e flukseve të rritura që do të kemi në aksin kombëtar - korridori VIII.</p> <p><i>Impakti i Pritur</i> Ndërtimi i mbikalimeve do të lehtësojë dukshëm trafikun në të gjithë pjesët e qytetit si dhe do të rrisë treguesit e trafikut , në kuptimin e rritjes të shpejtësisë mesatare në kushtet e sigurisë të trafikut për qytetin e Korçës</p> <p><i>Faza e projektit</i> Draft projekt</p> <p><i>Vlerësimi i prioriteteve</i> Afat shkurtër</p> <p><i>Përgatitja e projektit</i> Dy vjet</p> <p><i>Punimet e Zbatimit</i> Pesë vjet</p>

### Fisha e projektit - Transporti

	<b>Titulli i Projektit Konkret: PROJEKTIPËRMIRËSIMIT TË KRYQËZIMEVE</b>
--	---

Titulli i projektit

	<b>RRUGORE në Qytet</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SWOT)	Sipas Analizës SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik, Programin etj. : Bllokime të shpeshta të trafikut përreth qendrës së qytetit
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë : Disa kryqëzime të rëndësishme që ndodhen përreth zonës qendrore të Qytetit të Korçës, të cilët kanë aktualisht ngarkesë të madhe trafiku dhe kanë shfaqur probleme sigurie dhe funksionimi, do të përmirësohen përsa i përket shtrirjes dhe sinjalistikës rrugore. Në këtë projekt janë përfshirë 5 kryqëzime (shih hartën më poshtë). Përmirësimi i kryqëzimeve do të koordinohet me masa të tjera në drejtim të investimeve kapitale. (ku është e zbatueshme të realizohen këto projekte). <i>Objektivi i gjerë</i> Transport më i mirë urban dhe zhvillimi i aftësisë së planifikimit struktural si baza për një zhvillim pozitiv të qytetit. <i>Objektivi Specifik</i> Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të trafikut nga Bashkia
Fazat e Projektit  Dhe Termat Kohor	Për secilin nga kryqëzimet janë parashikuar këto masa veprimi: - Projektimi sipas funksioneve të rrugëve që lidh kryqëzimi; - Blerja e tokës për zgjerim të karrexhatave - Parashikimi i sistemit kullues  - Trajtimi i trotuareve  - Instalimi i semaforëve (nëse duhet). - Instalimi (nëse duhet) i shenjave të trafikut. • - Instalimi (nëse duhet) i tabelave të levizshme për stacionet dhe itinerarin e autobuseve
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	• Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore : -Ngritja e departamentit të Transportit në Bashki - Matje trafiku
Partnerët	Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit Bashkia & Konsulenti
Burimet e nevojshme për realizimin e projektit	-Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit : <i>Kostoja e vlerësuar e ndërtimit</i> 300 000 Euro , burimet e financimit nga Bashkia Korçë <i>Rrisqet Buxheti</i> i kufizuar
Treguesit e Monitorimit dhe  Rezultatet e pritshme	Indikatorët që masin Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrimi i Impaktit që do të ketë Projekti i Realizuar : <i>Projekti do të sigurojë</i> -Rritje të kapaciteteve të kryqëzimeve; -Rritje të sigurisë së këmbësorëve;  -Rritje të sigurisë së automjeteve;  -Zvogëlim i kohës së humbur në kryqëzime;

nga Projekti	<p>-Rritje të frekuencës të shërbimeve të transportit publik.</p> <p><i>Impakti i Pritur</i></p> <p>-Qytet i pastër, pa ndotje</p> <p>-Rritja e sigurisë për banorët</p>
--------------	--

### Fisha e projektit - Transporti

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret : REHABILITIMI I RRUgËVE URBANE TË</b>
Objektivi Strategjik/	<b>Qytetit</b> Sipas Analizes SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik,
Programi (SWOT)	Programin etj. : Gjendja ekzistuese e rrjetit rrugor kërkon një projekt tërësor për rehabilitimi e tij.
Përshkrimi i Projektit	<p>Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë : Projekti konsiston në rehabilitimin e rrjetit të rrugëve parësore dhe dytësore të qytetit të Korçës (afërsisht 121 km) duke përfshirë marrjen e këtyre maseve:</p> <p>-nga trajtimi i sipërfaqes dhe shtrimit për të përfunduar me rindërtimin dhe parashikimin e sistemit të drenazhimit, në varësi të gjendjes aktuale të çdo nyjeje. Të gjitha kryqëzimet midis rrugëve të kategorisë së parë e të dytë do të përmirësohen nga ana strukturore dhe funksionale.</p> <p>Sinjalistika vertikale dhe horizontale dhe shenjat rrugore janë të përfshira në Projekt. Prioritetet do të përcaktohen në pjesën e dytë të studimit.</p>
Fazat e Projektit dhe Termat Kohor	<p><i>Veprimet Strategjike</i></p> <p>Faza A</p> <p>-Përcaktimi i standarteve për rehabilitimin e rrugëve dhe çmimi për Njësi.</p> <p>-Përcaktimi i programit për rehabilitimin e rrugëve.</p> <p>-Dhënia e përparësisë sipas analizës ekonomike, funksionimit dhe Gjendjes aktuale të rrugëve.</p> <p>-Përgatitja e projektit teknik dhe dokumentave për tender për dy vitet e para të zbatimit të projektit</p> <p>Faza B1, B2, etj.</p> <p>-Zbatimi i punës bazuar në dy vitet e para të ndërtimit;</p> <p>-Përgatitja e projektit teknik dhe dokumentave për tender për dy vitet e para të zbatimit të projektit.</p> <p><i>Impakti i Pritur</i> - Qytet i pastër, pa ndotje</p> <p>-Rritja e sigurisë për banorët.</p> <p><i>Rrisqet Buxhet</i> i kufizuar.</p> <p><i>Kostoja e vlerësuar e ndërtimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shënim: Veprimet Bazë Strategjike</li> </ul>
Ndryshimet	Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë



e nevojshme Institucionale dhe ligjore	ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore : Krijimi i departamentit të transportit pranë Bashkisë dhe trajnimi i stafit
Partnerët	Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit : Bashkia
Burimet e nevojshme për realizimin e projektit	-Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit : Bashkia e Korçës & Fondi i Zhvillimit Rajonal. 46 000 000 Euro vlerësohet kostoja paraprake e të gjithë koston së projektit. Duke marrë parasysh kërkesat e mëdha për fonde Konsulenti propozon të përfshihen vetëm disa faza në projektin 10 vjeçar për rehabilitimin e rrugëve. Shuma fikse vjetore për të gjithë kohëzgjatjen e projektit 15 vjeçar mund të përcaktohet nga një politikë e përshtatshme financiare
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	-Indikatorët që masin Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrim i Impaktit që do të ketë Projekti i Realizuar : Vlerësimi i gjendjes të rrjetit rrugor nëpërmjet përcaktimit të “nivelet të komoditetit në transport” në Bashki nëpërmjet treguesit “IRI” i përcaktuar nga BB si kriter për mirëmbajtjen e rrjetit Rrugor Qendror Shqiptar në kontratën e fundit për programin e Mirëmbajtjes të rrjetit rrugor me një fond prej 120 milion \$ me MIT <i>Rezultatet e pritshme të Projektit</i> Ulja e koston për mirëmbajtjen e mjeteve. Rritje e kapacitetit lidhës të transportit Rritje të shpejtësisë mesatare të udhëtimit. Përmirësim i sigurisë. Përmirësim i mjedisit. <i>Objektivi i gjërë i këtij projekti është krijimi i një mjedisi që mundëson një zhvillim tërësor dhe miqësor ndaj mjedisit të Bashkisë.</i> <i>Objektivi Specifik</i> Rehabilitimi i rrugëve që ndikojnë në zhvillimin e qytetit

### Fisha e projektit - Transporti

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret RREGULLORE E KLASIFIKIMIT TË RRUGËVE URBANE</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SWOT)	<b>Sipas Analizës SWOT, të lidhet Titulli i Projektit me Objektivin Strategjik, Programin etj.</b> Problemet e rregullimit të trafikut dhe të parkimit në qytetin e Korçës kanë nevojë për një Rregullore të Klasifikimit të Rrugëve Urbane në Qytetin e Korçës .
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, çfarë do të arrijë : -Qëllimi i këtij projekti është përcaktimi i klasifikimit të rrjetit rrugor urban, i karakteristikave gjeometrike, funksionin dhe prioritetet e rrjetit rrugor, në përputhje me prioritetet funksionale, administrative dhe organizative të përcaktuara sipas Kodit Rrugor të Shqipërisë.
	-Planifikimi i Projektit, fazave të tij /planifikimi financiar Ky projekt po përgatitet nga Konsulenti , duke prodhuar grafën e rrjetit rrugor në GIS , dhe do të plotësohet në vijim nga Stafi i Bashkisë , përkatësisht nga departamenti



<p>Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor</p>	<p>i urbanistikës dhe i Transportit (propozuar që të ngrihet pranë Bashkisë së re) duke realizuar inventarizimin e rrjetit rrugor si një bazë e nevojshme të dhënash për një planifikim shkencor të gjithë projekteve dhe studimeve të transportit në këtë bashki</p> <p>-Sensibilizimi i komunitetit si dhe vlerësimi i Impaktit Mjedisor</p> <p>Nëpërmjet këtij projekti ,qytetarët duhet të njihen me ndryshimet që do të kryhen në të ardhmen në rrjetin rrugor urban të qytetit të tyre , për të dhënë mendime dhe sygjerime praktike në këtë drejtim</p> <p>-Miratimi i Projektit sipas bazës ligjore në fuqi</p> <p>Projekti mbështetet në kërkesën për hartimin e PUT sipas Kodit Rrugor dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak</p> <p>- Miratimi i Buxhetit</p> <p>Bëhet nga Bashkia për të mbuluar shpenzimet për vrojtuesit që do të punojnë në terren për plotësimin e të dhënave të nevojshme të përcaktuara në manualin përkatës që do përgatitet nga konsulenti.</p> <p>-Proçesi i Tenderimit Bashkia</p> <p>-Proçesi i Zbatimit Bashkia</p> <p>-Proçesi i Monitorimi e Kolaudimit të Projektit Bashkia</p> <p>Shënim: Veprimet Bazë Strategjike : Kryesisht do të punohet nga ekspertët e gisit në bashki dhe të dhënat plotësuese që kërkohen nga formularët per plotësimin e të gjithë të dhënave të këtij inventarizimi ,dhe që më pas do të hidhen në Bazën e të dhënave GIS si një bazë të dhënash për të gjithë projektet e të ardhmes .</p>
<p>Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore Partnerët</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të bërë të mundur realizimin e projektit, të evidentohen më parë ndërhyrjet Institucionale dhe ligjore :</li> </ul> <p>Në këtë kuadër është propozuar ngritja e “Departamentit të Transportit” në Bashki</p> <p>Institucionet Përgjegjëse për Realizimin e Projektit : Konsulenti dhe Bashkia Korçë</p>
<p>Burimet e nevojshme për realizimin e projektit</p>	<p>-Kostimi i Projektit dhe Burimet e financimit :</p> <p>Kosto e këtij projekti do të shpërndahet në kohë pasi projekti do të realizohet në faza, fillimisht në inventarizimin e rrjetit rrugor primar, pastaj të rrjetit rrugor sekondar dhe në fund të rrjetit rrugor tercial (local).</p> <p>Burimet financiare do të jenë të Bashkisë.</p> <p>Kosto e përafërt 300,000 euro</p>

#### 4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË KORÇË 2023-2025

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Korçë gjatë periudhës 2023-2025, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Korçë

## Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë

	Të Pergjithshme	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i Njësive Administrative	7.0					
Numri i Fshatrave	-					
Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )	806.0					
Qyteti	14.3					
Njësitet Administrative	791.7					
Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )	806.0					
Zonë Urbane	25.2					
Tokë Bujqësore	161.3					
Kullota	181.2					
Pyje	277.4					
<b>Popullsia e Bashkisë</b>		130,416.0	130,243.0	131,274.0	131,274.0	131,274.0
Qyteti		87,826.0	87,827.0	87,789.0	87,789.0	87,789.0
Njësitet Administrative		42,590.0	42,416.0	43,485.0	43,485.0	43,485.0
<b>Mosha Mesatare e Popullsisë</b>		-	-	-	60 vjec	-
<b>Numri i Lindjeve</b>		597.0	1,129.0	970.0	759.0	-
<b>Numri i Vdekjeve</b>		655.0	664.0	827.0	811.0	-
<b>Numri i Bizneseve Aktive</b>		-	-	-	3,315.0	-
<b>Numri i Familjeve</b>		42,480.0	42,837.0	43,321.0	43,321.0	-
Qyteti		29,921.0	30,184.0	30,379.0	30,379.0	-
Njësitet Administrative		12,559.0	12,653.0	12,942.0	12,942.0	-
<b>Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë</b>		986.0	995.0	1,025.0	1,050.0	1,270.0
Administrata e Bashkisë		226.0	247.0	248.0	241.0	376.0
Njësitet Shpenzuese		760.0	748.0	777.0	809.0	894.0
<b>Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme</b>		-	-	-	-	-
Administrata e Bashkisë		-	-	-	-	-
Njësitet Shpenzuese		-	-	-	-	-
<b>Numri i Programeve Buxhetore</b>		-	-	-	-	-

## 4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Korçë në vitet 2023-2025

## 4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Korçë për vitet 2023-2025

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit


BURIMET BUXHETORE		2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
<b>A</b>	<b>Të Ardhura nga Burimet e Veta</b>	576,019	745,579	1,096,000	1,123,988	1,070,906	1,081,619	1,092,431
<b>A.1</b>	<b>Të Ardhura nga Taksat Lokale</b>	180,797	302,121	434,932	434,932	439,282	443,676	448,111
<b>A.1.1</b>	<b>Taksa vendore mbi biznesin e vogël</b>	5,253	6,175	5,473	5,473	5,528	5,583	5,639
<b>A.1.2</b>	<b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	119,932	147,834	269,319	269,319	272,013	274,733	277,480

A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	93,164	114,846	185,166	185,166	187,018	188,888	190,777
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	18,175	20,387	59,883	59,883	60,482	61,087	61,698
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	8,593	12,601	24,270	24,270	24,513	24,758	25,005
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.1.3</b>	<b>Taksa vendore në shërbimin hotelier</b>	3,943	5,957	6,500	6,500	6,565	6,631	6,697
<b>A.1.4</b>	<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	44,228	134,234	146,000	146,000	147,460	148,935	150,424
<b>A.1.5</b>	<b>Taksa e tabelës</b>	7,441	7,921	7,640	7,640	7,716	7,794	7,871
<b>A.1.6</b>	<b>Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.2</b>	<b>Të Ardhurat nga Taksat e Ndara</b>	64,061	94,693	156,296	156,296	157,858	159,439	161,032
<b>A.2.1</b>	<b>Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme</b>	2,907	22,932	26,606	26,606	26,872	27,141	27,412
<b>A.2.2</b>	<b>Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura</b>	38,618	43,263	40,029	40,029	40,429	40,834	41,242
<b>A.2.3</b>	<b>Taksa e rentës minerare</b>	396	331	236	236	238	241	243
<b>A.2.4</b>	<b>Taksa mbi të ardhurat personale</b>	16,719	22,091	24,000	24,000	24,240	24,482	24,727
<b>A.2.5</b>	<b>Taksa të tjera</b>	5,421	6,076	65,425	65,425	66,079	66,741	67,408
